



Raport mbi Diskutimin Publik të zhvilluar lidhur me Propozimin e Vendimit mbi Buxhetin e Komunës së Tuzit për vitin 2025.

Me konkludimin numër: 01-400/24-7410/1 datë 29.10.2024, Kryetari i Komunës së Tuzit, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Vendimit për Pjesëmarrjen e Popullsisë Lokale në Kryerjen e Çështjeve Publike, ka krijuar Projektvendimin për Buxhetin e Komunës së Tuzit për vitin 2025 me Programin e Diskutimit Publik, i cili është publikuar në ueb faqen e Komunës së Tuzit www.tuzi.org.me dhe i është dorëzuar këshilltarëve të Kuvendit të Komunës së Tuzit si dhe kryetarëve të Bashkësive Lokale.

Projektvendimi për buxhetin e Komunës së Tuzit për vitin 2025 është vënë në diskutim publik për 15 ditë, duke filluar nga data 18.11.2024, e me përfundim më 02.12.2024.

Sipas programit të përcaktuar, në ambientet e Kuvendit të Komunës së Tuzit më 02.12.2024 është mbajtur diskutimi qendror publik duke filluar nga ora 10:00.

Diskutimin publik në formë elektronike, me shkrim dhe me gojë e ka zhvilluar Komuna e Tuzit.

Gjatë diskutimit publik, qytetarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë iu dha mundësia të shprehin mendimet e tyre me shkrim, në mënyrë elektronike dhe me gojë.

Përfaqësues i propozuesit ishte z. Driton Gjokaj, sekretar i Sekretariatit për Financa, i cili bëri një prezantim hyrës mbi propozimin e vendimit përkatës.

U sqarua se Propozimi i vendimit për Buxhetin për vitin 2025 është përgatitur në bazë të nenit 8 të Ligjit për Buxhetin dhe Përgjegjësinë Fiskale ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 20/14, 56/14, 70/17, 04/18 dhe 55/18, 66/19 dhe 70/21, 027/23), neni 31 i Ligjit për financimin e vetëqeverisjes lokale (Fleta Zyrtare e Malit të Zi 03/19, 086/22, 005/24, 007/24), Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (" Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr.02/18, 34/19 dhe 38/20), të Statutit të Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi" – dispozitat komunale nr. 24/19, 05/20, 51 /22, 55/22).

I PROPOZIMI I VENDIMIT TË BUXHETIT TË KOMUNËS SË TUZIT PËR VITIN 2025

Diskutimet e pjesëmarrësve:

Driton Gjokaj, sekretar i Sekretariatit për Financa, njoftoi të pranishmit me Projektvendimin për Buxhetin e vitit 2025, si dhe prezantoi përmbajtjen e vendimit. Ai ftoi qytetarët që të pyesin gjithçka që u intereson, duke theksuar mundësinë e dorëzimit të sugjerimeve dhe komenteve në arkivin e Komunës si dhe me email.

PYETJE: Vendasit nga bashkësia lokale "Rakiq" paraqitën probleme në bashkësinë e tyre lokale sa i përket furnizimit me ujë dhe asfaltimit të rrugëve.

PËRGJIGJE: **Z. Lindon Gjellaj, kryetar i komunës**, tha se çështja e furnizimit me ujë do të zgjidhet përmes ndërtimit të një pusi në Milesh, e sa i përket asfaltimit, rrugët e diskutueshme i takojnë komunës së Podgoricës. Sa i përket rrugëve që i takojnë komunës së



Mali i Zi / Crna Gora
Komuna e Tuzit / Opština Tuzi
Sekretariati për financa
Sekretarijat za finansije
Nr./Br. 05-400/24-7410/4

Rruga Tuz nr. 1 , nr. 44
Ulica Tuzi br.1 , br. 44
+382 20 875 152
finansije@tuzi.org.me
Tuz – Tuzi, 09.12.2024. godine

Tuzit, mirëmbajtja e rregullt e rrugëve lokale është planifikuar përmes pozitës buxhetor Mirëmbajtja investuese.

PYETJE: Z. Marash Kalaj, kryetari i BL Ranza e Sukës, shtroi një pyetje lidhur me ndërtimin e ujësjellësit në atë vend, si dhe një pyetje lidhur me asfaltimin e pjesëve të caktuara të rrugëve.

PËRGJIGJE: Z. Lindon Gjellaj deklaroi se në Buxhetin e vitit 2025 është planifikuar Zhvillimi i Projektit Kryesor dhe vazhdimi i ndërtimit të ujësjellësit në Pikalë-Rranxa e Sukës si projekt që do të përfundojë në bashkëpunim me Drejtori për Investime Kapitale. Për sa i përket asfaltimit, buxheti për vitin e ardhshëm përmes pozitës buxhetore Mirëmbajtja investuese planifikon asfaltimin e rrugëve.

Sugjerimet e mëposhtme erdhen përmes email-it:

OJQ “Razvoj Vranj” – çështja e ndërtimit të shëtitorës në BL “Vrane” drejt Zbelit.

Përgjigje: Komuna e Tuzit deri në fund të marsit të vitit të ardhshëm do të lidhë marrëveshje me Drejtorin për investimet kapitale lidhur me këtë çështje.

Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural i komunës së Tuzit ka paraqitur propozim për rritje të subvencioneve në vlerë prej 39.000,00 euro dhe rritje të shumës së planifikuar për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e softuerit në vlerë prej 3.200.00 euro.

Përgjigje: Sugjerimet e lartpërmendura janë përfshirë në Propozimin e Buxhetit për vitin 2025.

Sekretar
Driton Gjokaj